



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË
INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I PLANIFIKIMI TË MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURËS

Relacion Teknik

Objekti: “Mirëmbajtje e rrugëve Rurale”

Lot I-rë: “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje të shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në Njësitë Administrative”

I. Vendndodhja e Shërbimit

Kontrata e shërbimit shtrihet në shtatë njësi administrative të Bashkisë Shkodër. Në bazë të inventarit të rrugëve të Bashkisë Shkodër, gjatësia totale e rrjetit lokal të asfaltuar është 152.55 km.

Nr.	Njësia Administrative	Numri I Rrugëve	Gjatësitë e Rrugëve lokale (ml)	Sip. Rrugëve lokale (m2)	Rrugë të Shtruara		Rrugë të Pa Shtruara	
					ml	%	ml	%
1	Rrethina	246	108,000	432,000	52,753	49%	55,247	51%
2	Postribë	51	78,239	312,956	40,170	51%	38,069	49%
3	Guri I Zi	94	60,046	240,184	11,996	20%	48,050	80%
4	Bërdicë	57	30,870	122,788	3,087	10%	27,783	90%
5	Dajç	61	61,120	244,480	12,224	20%	48,896	80%
6	Velipojë	38	40,370	250,790	26,820	66%	13,550	34%
7	Ana e Malit	100	71,170	284,680	5,500	8%	65,670	92%
	SHUMA	647	449,815	1,887,878	152,550		297,265	

Për vitin 2023 parashikojmë mirëmbajtjen e rrugëve në shtatë njësitë administrative si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi I Rrugës	Njësia administrative
1	Rruga Fisnikeria, fshati Golem.	Rrethina
2	Rruga Mollaj, Dobraç	Rrethina
3	Rruga Isa Jakupi, Dobraç	Rrethina
4	Rruga Muçaj, Dobraç	Rrethina
5	Rruga Sektorit, Shtoj I Ri	Rrethina
6	Rruga Begovi, Shtoj I Vjeter	Rrethina
7	Rruga Rozafa, Grude e Re	Rrethina
8	Rruga Morana, Grude e Re	Rrethina
9	Rruga Kaskada, Grude e Re	Rrethina
10	Rruga Kabineti, Grude e Re	Rrethina
11	Rruga Pisha, Grude e Re	Rrethina
12	Rruga Blloku I Ri, Bleran	Rrethina
13	Rruga Shtate Bajraktaret, Bardhaj	Rrethina

14	Rruga qender Bardhaj.	Rrethina
15	Rruga Qender Mes - Kullaj	Potribe
16	Rruge të brendshme fshati Kullaj (rruga Danaj, Bajraktareve dhe e Shkolles)	Potribe
17	Rruge të brendshme fshati Dragoç (rruga Halilaj dhe e ish-stallës)	Potribe
18	Rruga Boks - Ura e Rasekut	Potribe
19	Rruga Boks - Lagjja Rasek, fshati Boks	Potribe
20	Rruga e Spahijajve - Bajraktar, fshati Boks	Potribe
21	Rruga Qender Mes - Ura e Mesit	Potribe
22	Rruga Qender Mes - Myselim	Potribe
23	Rruga Domen	Potribe
24	Rruga Vukatanë - Guri I Zi	Guri I Zi
25	Rruga Kuç - Vukatanë	Guri I Zi
26	Rruga Vukatanë - Juban	Guri I Zi
27	Rruga e Xhamisë, Guri I Zi	Guri I Zi
28	Rruga Guri I Zi - Sheldi	Guri I Zi
29	Rruga Kuç	Guri I Zi
30	Rruga Ganjollë	Guri I Zi
31	Rruga Kryqezim - rruga e Velipojes	Dajç
32	Rruga qender Trush	Berdicë
33	Rruga Malsorët e Mullinit	Berdicë
34	Anashkalimi I Bërdicës	Berdicë
35	Rruga Cas Pentar	Velipojë
36	Rruga Oblikë – Obot	Ana e Malit
37	Rruga Muriqan - Goricë	Ana e Malit
38	Rruga Oblik – Xhaferaj	Ana e Malit
39	Rruga Lagjja e Re, Oblikë	Ana e Malit

II. Synimi i Shërbimit

- Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë;
- Të përmirësojë rrjetin rrugor të asfaltuar, nëpërmjet riparimit të dëmtimeve të shkaktuar nga agjentet atmosferike dhe amortizimi;
- Rritjen e jetëgjatësisë së rrugëve;
- Të rrisë sigurinë e lëvizjes në rrugë të përdoruesve.

III. Preventivi i Punimeve

Preventivi i punimeve është hartuar në bazë të VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 dhe parashikon këto punime:

- Punime për riparimin e asfaltit të dëmtuar në shtatë njësitë administrative. Kërkesat përfshijnë prerjen e gropave. Gropa duhet të pritët sipas një figure të rregullt gjeometrike (katrore apo drejtkëndeshë) me faqe paralele me aksin e rrugës ose me anët e shtresës ekzistuese. Faqet duhet të jenë të prera vertikalisht. Pjesët e paqëndrueshme duhet të hiqen dhe gropa duhet të pastrohet me ajër me presion të lartë para se të sprucohen me prajmer dhe me pas do të behet shtrimi me asfalt. Bashkimi duhet të lidhet me emulsion bituminoz.
- Punime për ndërtimin e mureve mbajtëse të rrugës. Në njësinë administrative Guri i Zi, rruga e Xhamisë, dhe në njësinë administrative Ana e Malit, rruga Xhaferaj janë parashikuar ndërtimi i mureve mbajtëse të rrugës për të shmangur prishjen e mëtejshme të rrugës nga gërryerja e përrenjeve dhe ujërave sipërfaqësore të rrugës.
- F.V Barriera mbrojtëse të rrugës Guardrail janë parashikuar të vendosen në ato segmente të cilat janë dëmtuar nga aksidentet rrugore (rruga Vukatanë, njësia administrative Guri i Zi), si dhe shtimin e tyre në disa segmente të tjera të domosdoshme për rritjen e sigurisë rrugore (në njësitë administrative Guri i Zi dhe Ana e Malit). Vendet e instalimit të tyre do të tregohen në objekt nga mbikëqyrësi i punimeve.

IV. Vlera e Kontratës

Vlera totale e kontratës është 7,840,736 lekë me tvsh në përputhje me preventivin për të gjithë shërbimin që do të realizoj.

Ky shërbim financohet nga busheti i Bashkisë Shkodër sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër” .

V. Afati i Kontratës

Afati I kësaj kontrate është 6 muaj nga lidhja e kontratës.

VI. Organizimi i Punimeve.

Për të gjitha proceset e punës, duhet të zbatohen me rigorozitet kushtet teknike të zbatimit të punimeve gjatë ndërtimit dhe të përdoren materiale për ndërtim, sipas standarteve shteterore.

VII. Mbikëqyrja e Punimeve.

Spektori i Planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës, kryen monitorimin e zbatimit e shërbimit.

Spektori i Planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës:

Përgjegjës Spektori: Ing. B.Jukni

Specialist: Ing. A.Kraja